

Dr. Qani Nesimi

Ballkani dhe toleranca osmane në shek. XIV-XVII^{*}

*“Në këtë shtet, krahas ushqimit të frengut (katolikëve), e preferojmë çallmën dhe shpatën e osmanit”
(Gennadios - lider shpirtëror në Bizant)¹*

Ardhja e shtetit osman Ballkanin e gjeti në një pozitë shumë të vështirë sa i takon respektimit të së drejtës nacionale dhe fetare të tjetrit. Këtu dominonte fryma asimiluese e inicuar dhe e realizuar nga serbët dhe grekët, të cilët vepronin në emër të ortodoksizmit, dhe nga katolikët, të cilët vepronin si propagandues të lëvizjes uniate të mëvonshme. Kjo armiqësi ishte rezultati i skizmës së madhe (viti 1054) që ndodhi me ndarjen midis kishës lindore dhe kishës perëndimore. Ata që më tepër vuanin nga kjo ishin kundërshtarët e konceptit të jetës dhe politikës së kishës krishtere, gjegjësisht kishës ortodokse. Në mesin e tyre mund të numërohen muslimanët e pakët në numër të Ballkanit para ardhjes së shtetit osman, bogomilët dhe paganët, pasi nuk ka mundësi të argumentohet se të gjithë ballkanasit, pa asnjë përjashtim, kanë qenë të krishterë.²

Shteti osman, i cili paraqitet në situatën e lartpërmendur, kronologjikisht është njëri prej shteteve islame.³ Ai ishte një shtet me një shoqëri multietnike dhe multikonfesionale,

^{*} Ky artikull përbën thelbin e punimit të doktoraturës, të cilën autori e ka mbrojtur më 27 dhjetor 2006, në Institutin për Histori Nacionale në Shkup.

¹ İ. Ortaylı, *Osmanlı'yi Yeniden Keşfetmek*, Stamboll, 2006, f. 66.

² Shih, N. Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Logos A, Shkup, 1998, f. 179-193, 247-252; Q. Nesimi, *Krishterimi 2000, pse?*, *Dialogu obligim hyjnor*, Logos A, Shkup, 2005, f. 108-115; Q. Nesimi, *Ortodoksizmi te shqiptarët*, Tetovë, 2005, f. 65-72; H. Inalxik, *Osmanskata Imperija, klasično doba 1300-1600*, Slovo, Shkup, 2002, f. 14-15; *Islam i Muslimani u Bosni i Hercegovini*, el-Kalem, Sarajevë, 1991, f. 19-28; N. Bozbor, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 30-32; M. Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët*, Toena, Tiranë, 2004 f. 44-64.

³ Në lidhje me këtë, është me rëndësi të theksohet se, shteti i parë islam ka qenë i formuar nga Pejgamberi i fundit Muhammedi a.s. në qytetin e Medinesë në Arabinë Saudite, pastaj i njëjti shtet ka qenë i udhëhequr nga hulefai-rashidinët (pasardhësit e Muhammedit a.s.). Ndërkaq pas pasardhësve të Pejgamberit kanë pasuar: emevitët, abasitët, selxhukët, dhe në fund osmanët. Në shek. XX ka disa shtete

kurse në asnjë mënyrë nuk ishte shtet njënacional. Shprehjet që përdoren për këtë shtet se ai ishte shtet turk e jo osman, se ata kanë qenë turq e jo osmanë, nuk janë për asgjë tjetër, vetëm se për ta minimizuar madhësinë dhe përkatësinë fetare të shtetit. Të thuash shteti turk është vetë shteti osman, në sferën historike, shkencore dhe kulturore është gabim shumë i madh. Pasi i pari është shtet nacional me kulturë, gjuhë dhe nacion të kufizuar. Ndërkaq shteti osman, edhe pse është e vërtetë se element dominues në të ka qenë elementi turk, ka kuptim shumë më gjithpërfshirës. Osmanë nuk janë vetëm turqit, por të gjithë popujt shtetformues në të: arabët, shqiptarët, kurdët, boshnjakët etj.⁴ Prandaj, nëse thuhet se shteti osman është vetëm shtet turk, atëherë për shqiptarët është një nënçmim shumë i madh, sepse atyre u mohohet pjesëmarrja aktive në atë shtet, e kaluara historike dhe besimi i tyre islam.⁵ Pasi është më se e ditur se kjo nuk është tjetër vetëm se një propagandë antishqiptare e realizuar nga qarqe të ndryshme. Kështu është rasti me politikën ortodokse progreke, e cila shqiptarët muslimanë i quan *turkoalvano* (shqiptarë turq).⁶

Për periudhën e hershme të shtetit osman nuk ka argumente dhe të dhëna bindëse historike ku mund të bazohen mendimet e historianëve në lidhje me veprimtarinë e sulltan Osmanit I., të Orhanit dhe të Muratit I. Historia e atëhershme më tepër bazohet në një numër të dhënash gojore. Por, më vonë, sidomos në kohën e sulltan Mehmetit II. Fatihut dhe më vonë, ka mundësi që të bisedohet për mësimin e dokumenteve konkrete historike dhe të dhënave arkivore, sikur që janë dokumentet e dhëna në formë të beratit, fermanit, bujurulldisë, dekretit etj., prej nga buron edhe *kanun-i osmani* (ligji osman).

Nga fundi i shek. XIV, pasardhësit e sulltan Osmanit I. Gaziut, duke falënderuar fuqinë e aftësisë së tij, i cili është themelues i dinastisë osmane, dhe zhvillimin e ngjarjeve historike, formuan një perandori e cila do të shtrihej prej Danubit e deri në Eufrat. Themeluesi faktik i kësaj perandorie ka qenë sulltan Bajaziti I. (1389-1402), i cili njihej me epitetin “*Jëlldërëm*” (rufeja). Sulltan Pajaziti I. pati një fitore të plotë në Nikopol në vitin 1396 kundër kryqëzatave, e cila ishte njëra prej ushtrive më mburëse në Evropën e atëhershme. Ai gjithashtu ka treguar vendosmëri ndaj memlukëve, e ka provokuar Tamerlandin e Azisë së Mesme dhe të Iranit, edhe pse nga ky i fundit e ka humbur luftën.⁷

Qëllimi dhe ideali i luftës së shenjtë ose i gazasë-xihadit,⁸ është një faktor me rëndësi në themelimin, zhvillimin dhe përparimin e Perandorisë osmane. Rendi social dhe ekonomik i principatave kufitare ka qenë në përputhshmëri me modelin e caktuar kulturor dhe në përgjithësi i frymëzuar nga ideali i vazhdueshëm i luftës së shenjtë dhe nga

të reja që janë paraqitur si shtete islame, si: Pakistani, Sudani, Irani. Por, si shtet i fundit islam dhe fuqi botërore deri më sot llogaritet Shteti Osman.

⁴ İ. Ortaylı, *po aty*, f. 30-31; İ. Ortaylı, *Osmanlı Barışı*, Ufuk, Stamboll, 2005, f. 23-32.

⁵ Këtë e them sepse, mendoj se, ata të cilët e shprehin idenë se shteti osman ka qenë shumë i dëmshëm dhe shumë i keq, të njëjtit në prapavijë s’e pëlqejnë Islamin dhe nëpërmjet saj edhe osmanët. Kjo nuk është objektive dhe nuk është shkencore.

⁶ E. bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003, f. 152, 335-336; Nesimi, *Ortodoksizmi te shqiptarët*, f. 77-80.

⁷ H. İnalçık, *Osmanlı İmparatorluğu'nun Ekonomik ve Sosyal Tarihi 1300-1600*, v. 1, Stamboll, 2000, f. 48; H. İnalçık, *Osmanskata Imperija-klasično doba 1300-1600*, f. 9.

⁸ Gazi dhe shahid-dëshmor dhe gaza dhe xihad në këtë rast kanë të njëjtin kuptim. Në të dy rastet bisedohet për njeriun i cili lufton në rrugë të Allahut xh.sh. (Ş. Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, Ankara, 1998, f. 139).

zgjerimi kontinuitativ i *darul-islamit*, gjegjësisht i territoreve islame. Gazaja kuptohet si një detyrim religjioz, e cila përnjëherë i frymëzon besimtarët të jenë të gatshëm për çfarëdo lloji ndërmarrjeje dhe flijimi.

Qëllimi i luftës së shenjtë nuk ka qenë shkatërrimi, por ka qenë nënshtrimi i botës së jomuslimanëve, gjegjësisht i *darul-harbit*.⁹ Profesor I. Bardhi në një shkrim të tij me titull “Lufta e ‘shenjtë’ në religjionet monoteiste”, vë në pah tri kuptimet e xihadit, të cilat shprehin edhe dimensionet më të rëndësishme të xihadit të përmendur në Kur’an. Sipas profesor Bardhit xihadi ka kuptimin e luftës kundër vetvetes dhe shpirtit që dëshiron keq, luftës për përhapjen e islamit apo luftës kundër pabesimtarëve dhe luftës brenda rradhëve të veta kundër muslimanëve jo të mirë.¹⁰ Osmanët i kanë hedhur themelet e shtetit të tyre botëror duke e bashkuar Anadollin dhe Ballkanin e krishter nën patronatin e tyre. Shteti islam me anë të luftës së shenjtë¹¹ ka kontribuar edhe si mbrojtës i kishës ortodokse dhe i miliona të krishterëve të tjerë ortodoksë. Islami ka garantuar të drejtën e jetës dhe të pasurisë edhe për të krishterët edhe për hebrenjtë, me një kusht që ata t’i nënshtronen shtetit dhe të paguajnë tatimin (xhizjen).¹² Islami u ka lejuar që ata lirshëm t’i zbatojnë bindjet e tyre fetare dhe të jetojnë në përputhshmëri me ligjet e fesë së tyre. Kështu osmanët, duke jetuar bashkë në një bashkësi me të krishterët, nga ana e tyre ata me një zemërgjërësi dhe me një tolerancë të madhe i kanë realizuar këto parime të Islamit. Në vitet e para të themelimit të perandorisë osmane, politika e udhëheqësve ka qenë që të mundësojë nënshtrim vullnetar të shteteve dhe të principatave krishtere dhe të fitojnë besimin e tyre para se të kapin armën.¹³

Kështu është rasti edhe me sinjorët (vasalët) shqiptarë, të cilët i kishin pronat e tyre dhe i takonin besimit krishter. Shteti osman, me kusht që ata të pranojnë autoritetin e tij, familjeve vasale të krishtera shqiptare, si: balshajt, topiatët, dugagjinët, zakariotët, musakët, zenebisët, aranaitët, vullkashinët, kastriotët etj., gjegjësisht sinjorët e tyre i pranoi si legjitim, duke mos kërkuar që ata të ndërrojnë besimin e tyre. Sipas *tahrir defter*-it të vitit 835 hixhri (1431-1432), si vilajete të njohura shqiptare të asaj kohe mund të llogariten: vilajetet e Pavle Kurtikut, Balshajve, Aranitid Kondo Mitkos, Dimitri Gonimas; pastaj krahina e Ashtinit (*Astin ili*), i Gjonit (*Yovan ili*), nahija e Bogdan Ripes. Gjoni ka

??

⁹ Në literaturën islame përmenden terme si: *darul-harb*, shtëpia e jomuslimanëve, gjegjësisht shteti që nuk është nën shtetin islam, dhe *darul-islam*, shtëpia e islamit, vendi ku jetohej sipas rregullave islame. Përveç këtyre ka edhe një term tjetër që e përmend S. H. Nasr, i cili është *darus-sulh*, shtëpia e paqës. (S. H. Nasr, *Srce Islama*, Sarajevë, 2003, f. 211-214; I. R. el-Faruki, *Islamic Ethics, World Religions And Global Ethics*, ed. S. C. Crawford, New York, 1989, f. 221-225).

¹⁰ I. Bardhi, Lufta e “shenjtë” në religjionet monoteiste, *Përmbledhje punimesh*, nr. 1, viti 1, Shkup, 2002, f. 22.

¹¹ Edhe pse gjithmonë me fjalën luftë mendohet në diçka që është shkak për çrregullim në mes të njerëzve dhe për prishje të gjithçkafit që është e ndërtuar, në kuptimin islam lufta ose xihadi islamik nuk ka për qëllim të krijojë çrregullime ose të prishë diçka. Por, në konceptin religjioz islamik relacionet mes njerëzve, pa dallim feje, nacioni, lufta e shenjtë apo xihadi-gaza ka kuptimin e formimit dhe të garantimit të rendit, të së drejtës individuale dhe shoqërore të njerëzve që jetojnë në atë shoqëri. Për këtë në literaturën islame gjenden dy lloje të xihadit: xihadi i vogël dhe xihadi i madh. Xihadi i vogël ka kuptimin e luftës e cila zhvillohet në fushëbetej kundër armikut. Ndërkaq, xihadi i madh ka kuptimin e formimit të rendit duke luftuar së pari me vetveten, gjegjësisht me fuqinë e brendshme e cila njeriu e çon drejt punëve të këqija. (R. Guenon, *Simbolika krsta*, Beograd, 1998, f. 45-47; I. Bardhi, po aty.)

¹² *Osmanlı Başbakanlık Arşivi İstanbul (OBAİ), Kilise Defterleri (KD)*, nr. 8, f. 5-6; *OBAİ, Muhimme Defteri (MD)* 89, nr. 265, f. 86; 64, nr. 538, f. 210; nr. 31, f. 220; *OBAİ, Gayrimuslimlere Ait Defterler (GD)*, nr. 18, f. 42.

¹³ H. Inalxik, *Osmanska Imperija-klasično doba 1300-1600*, f. 10-11.

qenë babai i Skenderbeut, kurse ka administruar me kastriotët. Pavlo Kurtiku, si një i krishter ka poseduar një timar të madh në pjesën veriore të Elbasanit të sotëm. Ndërkaq pas tij kanë vazhduar bijtë (Isa beu, Sinan beu, Mustafa), nipat (Husein) dhe familjarë të tjerë të tij.¹⁴ Pra, siç kuptohet prej emrave të pasuesve të Pavlo Kurtikut, ata të gjithë kanë qenë muslimanë. I njëjtë ka qenë rasti edhe me vasalët e tjerë si: me djemtë e Karlos (Karli), djemtë e Zaganosit, djemtë e Gjonit etj.¹⁵

Hyrjen e viseve të Ballkanit nën sundimin osman e kanë kushtëzuar kushtet gjeografike. Osmanët duke ndjekur rrugën *Via Ignatia*, në vitin 1385, nëpërmjet qytetit Ser, Manastir dhe Ohër, nga ana perëndimore arrijnë deri te bregu shqiptar. Sinjorët e rajonit (Shqipëri) e kanë pranuar autoritetin e shtetit osman. Linja e dytë ka depërtuar nëpërmjet Selanikut (Thesalonika) në vitin 1387. Linja e tretë e ka ndjekur rrugën prej Stambollit (Konstantinopolis) drejt Beogradit, kështu që fusha e Maricës pa ndonjë reaksion shumë të ashpër më 1365 bie nën shtetin osman. Koha e depërtimit të osmanëve përkon me përçarjen politike që ndodh në mes të shteteve ballkanike, pasi që në atë kohë shumë mbretër, dhespotë, princë të principatave kufitare, për t'i zgjidhur problemet e tyre të brendshme, pa hezitim kanë kërkuar ndihmë nga jashtë. Brenda atij kaosi që dominonte në Ballkan, osmanët udhëhiqnin një politikë të përshtatshme dhe vetëm ata posedonin fuqi ushtarake dhe sistem qendror, e cila ishte e dopmosdoshme për mbajtjen e rendit në Ballkan. Osmanët kishin edhe një përparësi pasi posedonin korpusin e jeniçerëve, i cili, sipas profesor Inalxhikut, ishte ushtria e vetme e rregullt në Evropë. Shikuar nga një anë tjetër, në çdo ushtri ballkanike të krishterë ekzistonin fraksione, ku disa dëshironin të bashkoheshin me hungarezët, kurse të tjerat me osmanët. Për shembull, popullata greke ortodokse ka reaguar në mënyrë fanatike kundër dominimit të italianëve dhe kundër çdo lloji të ndikimit të kishës katolike. Kështu që grekët filluan që osmanët t'i llogaritin për aleat dhe udhëheqës së tyre, pasi këta të fundit sinjorët krishterë i kanë pranuar edhe si të tyre. Në periudhën mes viteve 1346-1352, osmanët u futën në Traki si aleat të Jovan/Gjon Katakuzinit. Po ashtu, edhe kur bizantinët, hungarezët dhe vllahët bënë presion ndaj mbretit bullgar në vitin 1356 dhe 1366, osmanët i dërguan përforcime ushtarake si një aleat i tyre.¹⁶

??

¹⁴ H. İnalçık, "Arnavutluk'ta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey İsyanının Menşei, *Fatih ve İstanbul*, v. 1, nr. 2, Stamboll, 1953, f. 154-156, 159-161; İ. Ortaylı, *Osmanlı Barışı*, Stamboll, 2005, f. 117-120; N. Bozboran, *po aty*, f. 45-47.

¹⁵ Gjithë kjo është rezultat i sistemit gulam (devshirme), sipas të cilit të gjithë fëmijët e aristokracisë vendore kanë qenë të përgatitur për t'u futur në administratën e shtetit osman. Fëmijët e tillë profesionalisht janë përgatitur në Enderun, e cila ka qenë një lloj shkollë në sarajin e sulltanit. (Shih, İ. Ortaylı, *Osmanlı'ya Yeniden Keşfetmek*, f. 27-34, 173-177).

¹⁶ H. Inalçık, *Osmanska Imperija-klasično doba 1300-1600*, f. 15-16; I. Beldiceanu, "Fillimet: Osmani dhe Orhani", *Historia e Pernadorisë Osmane*, ed. R. Mantran, Tiranë, 2004, f. 38-39; L. Bazen, *Intelektualni i Kulturni Život u Osmanskom Carstvu, Pregled Historije Islamske Kulture i Civilizacije*, ed. I. Bušatlić, Sarajevë, 2004, f. 122-125; H. Poulton, *Balkanlar, çatışan azınlıklar, çatışan devletler*, Stamboll, 1993, f. 9-11; M. Imamović, *Historija Bošnjaka*, Sarajevë, 1998, f. 95-98.

Këtu mund të theksojmë se bashkëngjitja apo toleranca e osmanëve ndaj shteteve tjera, siç është në rastet e lartpërmendura, është një shembull për veprimet e sotme të shteteve të ndryshme të cilat dëshirojnë të futen në unionin e kombeve të bashkuara etj. Mendoj se sa është me rëndësi që i dobëti të bashkëpunojë me të fortin, aq është me rëndësi që edhe i forti t'i vlerësojë dhe llogarisë të dobëtit. Rasti i parë tregon pjekurinë e të dobëtit, kurse rasti i dytë tregon vendosmërinë e të fortit që të jetë ashtu si edhe e quan veten.

Për atë se osmanët erdhën në Ballkan për të shporur dhunën që e kishte kapluar, apo se ata kishin për qëllim të jenë vetëm formues të paqës dhe jo të dhunës tregon edhe rasti kur mbreti hungarez J. Hunyadi dëshironte ta okuponte Serbinë, mbreti serb Gjorgji Brankoviç, me një letër të shkruar dërgon një delegacion te Hunyadi, kurse një delegacion tjetër me të njëjtën letër e dërgon te sulltan Mehmeti II Fatihu. Brankoviç në atë letër ka shkruar: “Nëse shteti im (Serbia) bie nën sundimin tuaj, çfarë do të ndodhë me besimin tonë ortodoks”. Hunyadi përgjigjet: “Në çdo pjesë të Serbisë do të ndërtoj kisha katolike dhe do t’i prish kishat ortodokse”. Kurse sulltan Fatihu përgjigjet: “Pranë çdo xhamie do të ndërtoj nga një kishë ortodokse”. Pas kësaj përgjigje mbreti serb vendos të respektojë shtetin osman.¹⁷

Një tolerancë e tillë te osmanët kuptohet se buron nga ajo frymë fetare islame që bazat i ka në Kur’an dhe e cila shumë qartë mund të shihet te këshillat e shejhulislamëve dhe të qëndrimeve të vet sulltanëve ndaj jomuslimanëve. Veprime këto që jo atëherë, por edhe sot është shumë vështirë t’i hasësh tek shumë udhëheqës apo të dijetarë eminentë të botës.

Për shembull, shejhulislami Saduddin Efendiu në veprën e tij *Taxhut-Tevarih*, sulltan Orhanit i drejtohet me këto fjalë:

*“Dilerim ey sahib-i ikbal u cah
Etme sen canib-i zulme nigah
Adl ile bu alemleri abad kıl
Rasm-i cihad ile beni şad kıl
Rah-ı cihad icre edup ictihad
Memleket-i Rum’da adl u dad.”*¹⁸

(“Dëshiroj, o ti që përparon në fron,
Mos qëndro në anën e dhunës,
Me drejtësi ndërtoje këtë botë,
Me angazhimin tënd më gëzo,
Mundohu që me luftën tënde,
Në Bizant të mbjellish drejtësi”.)

Poashtu, në një edikt të sultan Mehmeti II. Fatihu për të drejtat që u janë dhënë të krishterëve latinë (katolikëve) në Bosnjë thotë: “...askush nuk ka të drejtë t’i pengojë kishat...çdo njëri është i sigurt në shtetin tim dhe kush dëshiron kur të dëshirojë mund të vijë dhe të vendoset këtu...asnjë nga vezirët e mi, nga populli im nuk ka të drejtë të sillt me nënçmim ndaj të tjerëve...jeta dhe kishat e tyre janë të mbrojtura me autoritetin tim..”¹⁹

Sulltan Selimi I. në hyrje të Jerusalemit ka qenë i pritur nga patriku armen Serkisi III., ku të njëjtit sulltani (viti 1517) i jep një edikt: “...kishat, manastiret dhe vendet e tjera të shenjta me cilat kushte kanë vepruar deri tash do të vazhdojnë edhe më tutje, pa ndonjë

??

¹⁷ A. Akgündüz, *İslam’da İnsan Hakları ve Beyannamesi*, Stamboll, 1997, f. 72; A. B. Kopanski, *Balkanlarda Osmanlı Barışı ve ‘Batı Meselesi’*, Ankara, 2000, f. 22-25.

¹⁸ Z. Kazıcı, *İslam Medeniyeti ve Medreseleri Tarihi*, Stamboll, 2003, f. 54.

¹⁹ G. G. Corm, *Prilog proučavanju multikonfesionalnih društava*, Sarajevë, 1977, f. 70-71.

ndryshim...askush prej vezirëve të mi nuk ka të drejtë të përzihet dhe të shqetësojë, të prishë ose të ndryshojë diçka...”²⁰

Historiani gjerman F. Babinger shprehet se, sulltan Mehmeti II. Fatihu, përfaqësuesve të kishës ortodokse u ka garantuar tri privilegje: asnjë kishë nuk do të shndërrohet në xhami²¹, askush nuk ka të drejtë të përzihet në rituale kishtarë dhe se të krishterët ortodoksë kanë të drejtë që t'i manifestojnë Pashkët.²²

Ndërkaq Gobineau në një debat të tij për religjionet në Azi, është shprehur se nuk ka fe më tolerante se Islami. Kështu që, ne nuk duhet të ndalemi tek ndonjë padrejtësi që është bërë për ndonjë moment të caktuar. Kështu mendon edhe orientalisti tjetër gjerman Mez.²³

Shteti osman me platformën e vet shumë të qartë dhe të trashëguar nga e kaluara religjioze²⁴ dhe e bazuar në shpalljen hyjnore-Kur'an dhe Sunnet, arriti që në Ballkan dhe më gjerë, madje edhe të jomuslimanët, të formojë bindjen se ata janë më të preferuarit se të tjerët. Nga kjo lind edhe shprehja “më mirë një fes osman sesa një mertek katolik”.²⁵

Pozita adekuate në planin religjioz e superfuqisë së ardhshme qëndron në atë se shteti osman është gjendur në vendin kufitar ku janë takuar, në një anë, dy religjionet më të mëdha monoteiste botërore, islami dhe krishterimi, kurse në anën tjetër, ekzistonte atmosfera e tendosur, e cila ishte rezultat i anatemizimit reciprok (skizma e madhe-1054) në mes të dy kishave të mëdha krishtere, katolicizmit dhe ortodoksizmit. Kurse pak më vonë krishterimi, sidomos kisha ortodokse, dhe hebraizmi do të marrin pozitën e tyre në strukturën sociale dhe ekonomike të shtetit osman, gjegjësisht në kuptimin multikonfesional dhe multinacional të tij.

Një moment tjetër me rëndësi që duhet theksuar dhe përmendur këtu dhe i cili paraqet një faktor relevant dhe vendimtar në Evropë dhe Ballkan, por që ka qenë jashtë kufijve të shtetit osman, është prezenca e kishës katolike, gjegjësisht e papës si një tutor dhe si një

??

²⁰ Y. Ercan, “Ermeniler ve Ermeni Sorunu”, *Osmanlı'dan Ermeni Sorunu*, ed. H. C. Guzel, Ankara, 2001, f. 83-84.

²¹ Janë disa arsye që një kishë të shndërrohet në xhami: nëse kisha tregon dominimin politik dhe fetar të vendit në fjalë; nëse në një kishë është thirrë ezani, i cili nuk ka qenë gjithmonë rregull për shndërrimin e një kisha në xhami; nëse muslimanët kanë patur nevojë për realizimin e obligimeve të tyre fetare; nëse vendasit janë bërë muslimanë kisha e tyre është kthyer në xhami etj. (Shih, Ph. Mansel, *Dünyanın Arzuladığı Şehir 1453-1924 Konstantinopolis*, Stamboll, 1996, f. 48-49; A. Refik, *Onüçüncü Asr-i Hicride İstanbul hayatı (1786-1882)*, Stamboll, 1988, f. 20; *Osmanlı Başbakanlık Arşivi İstanbul, Mühimme Defteri*, v. 71, nr. 584 (989/1581); v. 52, br. 44 (991/1583); v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588); v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588). v. 62, nr., 209 (995/1587); v. 62, nr., 403 (996/1588).

²² F. Babinger, *Fatih Sultan Mehmed ve Zamanı*, Stamboll, 2003, f. 105. Shih, M. Todorova, *Podbrani izvori za istorijata na balkanskite narodi XV-XIX vek*, Sofje, 1977, f. 47-49; S. Gerlah, *Dnevnik na edno ptuvane do Osmansliskata porta v Carigrad*, Sofje, 1976, f. 50.

²³ G. G. Corm, *po aty*, f. 188.

²⁴ Disa dijetarë të kohës së sotme me plotë të drejtë theksojnë se, edhe pse perëndimorët sot Islamin e shohin si një fe armike të modernitetit, islami tradicional është religjion i kompromisit, i cili është themeli i shoqërisë moderne. (Shih, S. Schwartz, *Dva Lica Islama*, Sarajevë, 2005, f. 51; M. A. Yamani, Islam And The West: The Need For Mutual Understanding, *The American Journal of Islamic Social Sciences*, v. 14, nr. 1, New York, 1997, f. 88-89; A. Stojanovski, *Vranjski Kadiluk u XVI Veku*, Vrajë, 1985, f. 50).

²⁵ I. Ortaylı, *Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek*, f. 66; A. B. Kopanski, *po aty*, f. 39; D. Goffman, *Osmanlı Dünyası ve Avrupa 1300-1700*, Stamboll, 2004, f. 74.

dirigjent i jetës politike dhe fetare të evropianëve, periudhë kjo në të cilën Europa e atëhershme vuante nga presioni i mentalitetit inkuizicionar i luftërave të kryqëzatave. Luftërat e kryqëzatave²⁶, kolonializmi klasik dhe anatemizmi i ushtruar ndaj botës islame vërtetohet me anë të qëndrimit negativ që ka ndikuar në formimin e qëndrimit fetar të krishterët ndaj islamit, sidomos të bota katolike. Gjatë këtij studimi është me rëndësi dhe me interes të theksohet se gjatë periudhës historike prej shek. XII e deri në shek. XV, është krijuar një literaturë e tërë, përmbajtja e së cilës është përplot paragjykime dhe qëllime propagandistike²⁷ në lidhje me personalitetin e të dërguarit të Allahut xh.sh., Muhammedit a.s. dhe me autenticitetin e librit hyjnor islam, Kur'anit a.sh., gjë kjo e cila nuk ndodh në botën islame, gjegjësisht në shtetin osman, kundër jomuslimanëve. Si shkrimtarë dhe autorë kryesorë të një literature të tillë antiislame mund të përmenden: I. Damaskin, N. Vizantiski, B. Ereshki, E. Zigabenos (shek. XI dhe XIII), N. Çaunates (1138-1214) etj. Në literaturën e theksuar më tepër është përmendur peygamberi islam, Muhammedi a.s., si mashtrues, antikrisht (karikaturat e sotme që u paraqitën në Danimarkë, Francë etj., dhe deklarata e papës Benediktit XVI se Islami sjell dhunë, mendoj se janë një vazhdimësi e asaj politike të atëhershme inkuizicionare); Kur'ani është trajtuar si një vepër ideologjike përplot me mashtrime dhe devijime; kurse arabët janë quajtur pasardhës të Ismailit, i cili është më pak i rëndësishëm se Ishaku, prej të cilit burojnë të krishterët.²⁸ Pra, nëse mendohet kështu, atëherë ku është ai dialogu dhe ku është ajo toleranca për të cilën bisedon dhe është përqëndruar bota moderne sot?

Po ashtu, periudha historike para dhe gjatë paraqitjes së shtetit osman, është një periudhë e humbjes së rolit të fesë (hyjnore-metafizikes) përballë shkencës dhe jetës sociale e ekonomike në shoqëri në kontinentin evropian, ku vend të rëndësishëm zë edhe Gadishulli Ballkanik. Kjo ishte periudha kur është paraqitur renesanca, për të cilën mendimtari islam bashkëkohor, S. H. Nasr, thotë se, ajo në bazë është joislame dhe ka frymë joreligjioze. Këto përpjekje që fillojnë në shek. XII, në kohët e mëvonshme do të përfundojnë me koncepte joreligjioze të të jetuarit, të mësuarit, të studiuarit dhe të organizuarit e jetës në përgjithësi. Ai vazhdon duke thënë se, ky koncept/sistem më vonë do të quhet sekularizëm/shekullarizëm, i cili definohet si mënyrë e dorëheqjes së njeriut nga mënyra e të jetuarit në mënyrë religjioze, si dhe prej metafizikes.²⁹ Në këtë drejtim shteti osman me karakterin e tij religjioz dhe me prezencën e tij në këtë rajon, ka luajtur një rol të madh në riaktivizimin ose rehabilitimin e jetës fetare, religjioze dhe metafizike.

??

²⁶ Duke u bazuar në pikëpamjet e lartpërmendura është e një rëndësie të veçantë të theksohet se, periudha e luftërave të kryqëzatave (1096-1453), sipas historianit turk profesor Inalxhikut, paraqet fytyrën e zezë të kishës katolike, bashkë me të edhe të politikës evropiane ndaj Islamit. Një gjë e tillë vërtetohet edhe me vendimin e papës ku më 25 nëntor 1366, deklarohet fillimi i luftës së kryqëzatave kundër shtetit osman. (Shih, H. Inalcik, *Osmanската Imperija-klasično doba 1300-1600*, f. 16).

²⁷ Në këtë moment është shumë me rëndësi të potencohet se bota e krishterë ka qenë e preokupuar me qëllime dhe ide paragjyuese dhe propagandistike kundër bashkësive të tjera religjioze. (N. Solomon, *Ko su jevreji, Judaizam*, ed. R. Hafizović, Sarajevo, 2005, f. 399-401).

²⁸ R. Hafizović, *Muslimani u dijalogu s drugima i sa sobom*, Sarajevë, 2002, f. 71-72; R. Hafizović, *Uzajamno priznavanje Islama i Kršćanstva, Znakovi vremena*, nr. 4, Sarajevë, 1998, (http://www.ibn-sina.net/zv/znakovi_tekst.asp?tekst_id=42&broj_id=3); Fra L. Markovic, *Polemika ili dijalog s islamom?*, Livno, 1995, s. 29-53; A. Silajdžić, *Islam u otkriće kršćanske evrope*, Sarajevë, 2003, f. 37-51; M. P. Durić, *Između turskog islama i katoličkog hrišćanstva, Forum Bosne*, nr. 19, ed. R. Mahmutčehajić, Sarajevë, 2002, f. 155-156; B. Luis, *Muslimansko otkriće Evrope*, Beograd, 2004, f. 26-49.

²⁹ E. Karić, *Nasr - mislilac svetog, Susret Čovjeka i Prirode*, ed. S. H. Nasr, Sarajevë, 2001, f. 216-217; S. M. N. el-Attas, *Islami dhe shkullarizmi*, Shkup, 2006, f. 42.

Shikuar në aspektin religjioz, është me rëndësi të potencohet se, në atë kohë në Ballkan ekzistonte edhe një kishë tjetër e quajtur kisha bogomile (patarene, babun), e cila e mori emrin sipas priftit Bogomil. Kjo kishë ballafaqohej me atë që të shpëtojë veten nga asimilimi³⁰ që ushtrohej nga mbretëria Hungareze dhe papa. Kështu që, ishte e detyruar³¹ të kërkojë strehim në qytetet osmane, gjegjësisht të bëhen muslimanë.³²

Sipas historianit A. B. Kopanski, në fillim të shek. XIV politika serbe ka filluar konkretisht të zgjerohet në jug të Ballkanit, e cila pjesë më herët ka qenë nën perandorinë bizantine. Serbët prej bizantinëve kanë trashëguar dy ideologji religjioze. E para, idenë për superioritetin e krishterimit. E dyta idenë e armiqësisë ndaj muslimanëve, e cila buronte nga frymëzimi i priftërinjve bizantinë që ata e kanë marrë në malin Atos. Ashtu që, mbreti serb, Stefan Dushani, vetveten e ka deklaruar: “Lider i të gjithë të krishterëve dhe kundër muslimanëve”. Kurse mbreti Stefan Nemanja qysh në vitin 1169 e ka okupuar Bosnjën, kurse popullatën e cila nuk e ka pranuar besimin ortodoks (bogomilët) e ka maltretuar dhe torturuar.³³

Dokumentet osmane janë ato që flasin për ekzistimin e një të drejte të qytetarëve, pa dallim feje dhe kombi që ai i takon-*sistemi Millet*, në shtetin osman. Kjo kuptohet duke u nisur nga temri millet, zimmi, muste'men, ehl-i kitab. Pra, së pari duhet ta kemi parasysh se ai nuk ishte një shtet nacional, e pastaj as që ndonjë besim të tjetër e llogaritte për armik.

Sistemi *Millet* në shtetin osman paraqitte një etnikum, i cili nuk kuptohej vetëm si një etnikum nacional, por ai në vete ngërthente një grup njerëzish që i tejkalonte kufijtë nacionalë. Në konceptin osman termi Millet, shikuar në aspektin historik, paraqet një fakt *sui generis*, që tregon se shteti osman është një bashkësi origjinale kulturologjike dhe sociologjike. Ky sistem nuk mund të krahasohet as me statusin e pakicave në shtetet kolonizuese e as me strukturën e shoqërive federative. Sipas dijetarëve relevantë të fushës së historisë sistemi Millet nuk mund në asnjë mënyrë të kuptohet si një sistem i pakicave, pasi ai i paraqet të gjithë përfaqësuesit e besimeve.³⁴ Për shembull si millet janë llogaritur katër grupe të mëdha në bazë religjioze: muslimanët, grekët (ortodoksë) bashkë me kishat tjera në Ballkan, armenët (gregorianë dhe katolikë) dhe hebrenjtë.³⁵

Ndërkaq, nga e gjithë kjo del se në shtetin osman njerëzit në aspektin religjioz janë klasifikuar në muslimanë (müslimler) dhe në jomuslimanë (gayrimüslimler). Dallimi në

??

³⁰ Si rezultat i situates së krijuar bashveziri Mahmut Pasha ka dërguar ushtri kundër mbretit boshnjak, S. Toma, me të cilën e ka rrethuar territorin e Bosnjës. Gjatë rrethimit në qytetin Jajce, vetëm për një ditë 36.000 e më tepër pjesëtarë të bogomilizmit kanë kaluar në Islam. (A. B. Kopanski, *po aty*, f. 31).

³¹ Në këtë drejtim kardinali I. de Torquemada ka publikuar një edikt drejtuar kundër tre bogomilëve boshnjakë: D. Kuciniç, S. Tvrtkoviç i R. Vociniç. Në vitin 1463 nga ana e papës princi boshnjak S. Toma ka qenë i shpallur për mbret të katolikëve romakë në Bosnjë. (*Dei gratia rex Bossine*). (A. B. Kopanski, *po aty*, f. 30-31).

³² A. B. Kopanski, *po aty*, f. 30-31; A. B. Kopanski, Islamization of Albanians in the middle ages: the primary sources and the predicament of the modern historiography, *Islamic Studies*, 36: 2-3, Islamabad, 1997, f. 191-199; H. M. Handžić, *Islamizacija Bosne i Hercegovine i porijeklo bosansko-hercegovačkih muslimana*, Sarajevë, 1940, f. 8; *Islamska Misao H. Mehmeda Handžića, Izbor Radova*, Sarajevë, 1994, f. 179-180; A. Handžić, *Population of Bosnia in the Ottoman Period*, IRCICA, Stamboll, 1994, f. 4-13.

³³ A. Kopanski, *po aty*, f. 13-14.

³⁴ B. Braude, Millet Sistemi'nin İlginç Tarihi, *Osmanlı'dan Günümüze Ermeni Sorunu*, ed. Hasan Celal Güzel, Ankara, 2001, f. 316; I. Ortaylı, *Osmanlı Toplumunda Aile*, Stamboll, 2002, f. 15.

³⁵ I. Ortaylı, *po aty*, f. 15-17.

mesin e tyre ka qenë në bazë të obligimeve që ata kanë patur ndaj shtetit. Jomuslimanët kanë patur edhe obligimet po edhe të drejtat e tyre. Së pari ata kanë patur statusin e tyre politik: dhimmi dhe muste'men.

Lirisht mund të themi se, asnjëherë të krishterët dhe hebrenjtë në shoqërinë multietnike islame nuk janë trajtuar ashtu sikur shteti katolik në Spanjë që i ka trajtuar hebrenjtë në shek. XIV-XV.³⁶

Dhimmi llogaritet një jomusliman që jeton në shtetin Islam dhe i posedon të gjitha të drejtat e tij me ligj shtetëror. Ibn Hanbeli dëmshpërblimin për vrasje (diyete) të një dhimmiu e barazon me atë të një muslimani, nëse vrasja ndodh me paramendim, nëse nuk ndodh me paramendim atëherë paguhet gjysma e dëmshpërblimit për vrasje. Imam Ebu Hanifeja ka qenë i vetmi që e ka lejuar gjykimin me vdekje të një muslimani nëse ai e ka mbytur një jomusliman.³⁷ Dhimmët në shoqëri multietnike dhe multikonfesionale islame kanë qenë të lirë të bëjnë tregti me mish derri, verë, ose të bëjnë ndonjë marrëveshje me kamatë.³⁸

Përveç dhimmive kemi edhe muste'menët, të cilët janë jomuslimanë që nuk jetojnë në shtetin islam (osman), por kur vijnë në këtë shtet kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Prandaj fjala muste'men ka kuptimin "i siguruar, në besueshmëri".³⁹

Prej obligimeve të jomuslimanëve ndaj shtetit osman janë haraçi dhe xhizja. Fjala haraç është fjalë arabe dhe ka kuptimin e taksës, gjegjësisht tatimit për tokën. Kurse xhizja është një taksë që merrej prej pasurisë materiale të cilën dhimmiu e posedon dhe është një marrëveshje në mes të shtetit islam dhe jomuslimanëve që jetojnë në atë shtet. Xhizja është detyrim që paguhet për të fituar garancinë dhe mbrojtjen shtetërore, me të cilën një dhimmi do të jetë i liruar nga shërbimi ushtarak. Pra një jomusliman i krishter do të paguajë xhizjen për t'i shërbyer arkës së shtetit, kurse një musliman një gjë të tillë e bën duke dhënë zeqatin, për të cilin jomuslimani nuk është i obliguar.⁴⁰ Dallimi në mes të haraçit dhe të xhizjes është se nëse një jomusliman bëhet musliman, prej xhizjes lirohet, kurse prej haraçit jo.⁴¹

Një çështje tjetër që duhet të përmendet është sistemi i devshirmesë. Devshirme ishte një sistem nëpërmjet të cilit zmadhohej numri i ushtarëve në shtetin Osman. Ligji për aktivizimin e devshirmesë daton nga koha e sulltan Muratit II., sipas të cilit ligj shteti osman prej popullatës jomuslimane (krishtere), gjegjësisht prej çdo 40 shtëpive të krishtera ka marrë nga një fëmijë mashkull të moshës të caktuar prej 8 deri në 18 vjeç, kurse më e realizueshmeja ka qenë prej moshës 14 deri në 18 vjeç. Ky ligj është praktikuar vetëm sipas nevojës së shtetit. Në çdo kadilluk, kudo që të ishte, në fillim popullata është lajmëruar për grumbullimin e devshirmesë. Pastaj fëmijët e krishterë me prindërit e tyre ose me shoqërimin e priftërinjve janë tubuar në vendin e caktuar. Me vete

??

³⁶ B. Lewis, *Çatışan Kültürler, keşif çağında hıristiyanlar, müslümanlar, yahudiler*, Stamboll, 2002, f. 23.

³⁷ G. G. Corm, *po aty*, f. 203; A. Matkovski, *Dietot-krvninata*, Shkup, 1973, f. 22.

³⁸ G. G. Corm, *po aty*, f. 203-204; B. Braude i B. Lewis, *Osmanlı Devleti İçerisinde Hıristiyanlar ve Yahudiler, Akademik Araştırmalar Dergisi*, viti 2, nr. 4-5, Stamboll, 2000, f. 174-177.

³⁹ H. Karaman, *Mukayeseli İslam Hukuku*, Stamboll, 1991, f. 243.

⁴⁰ H. Karaman, *po aty*, f. 273; Ibni K. el-Xhevzi, *Ahkamu ehli'dh-Dhimme*, Kajro, 2003, f. 23-25; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë, 1982, f. 397-398.

⁴¹ J. Kardavi, *Gajrimuslimin fi'l-muxh teme'il-islamij*, f. 32; E. Mardin, *Harac, İslam Ansiklopedisi*, tom 5/1, Stamboll, 1988, f. 222.

ata kanë patur edhe defterët ku kanë qenë të regjistruar emrat e fëmijëve devshirme. Të tillët u janë dorëzuar kompetentëve si kadiut, spahiut ose qehasë së fshatit. Të gjithë ata që janë marrë me devshirmenë janë paguar nga ana e shtetit.⁴² Ky ligj në fillim është realizuar vetëm në pjesën evropiane të shtetit osman (Ballkan), kurse kah fundi i shek. XV ka filluar të praktikohet edhe në popullatën e krishterë në Anadoll.⁴³ Sistemi i devshirmesë një jomuslimani ia mundëson që ai të marrë pjesë në ushtrinë dhe administratën osmane, kurse një musliman nuk merret si devshirme, por ai shkon ushtar. Ky është një lloj balansi që shteti osman e ka bërë në mesin e njerëzve, pa dallim feje.

⁴² A. Özcan, Organizacija Vojske kod Osmanlija, *Historija Osmanske Države i Civilizacije*, Sarajevë, 2004, f. 416.

⁴³ A. Özcan, po aty, f. 414-415; İ. Ortaylı, *Osmanlı'yı Yeniden Keşfetmek*, Stamboll, 2006, f. 27-34; A. Özcan, "Devşirme", *İslam Ansiklopedisi*, v. 9, Stamboll, 1994, f. 254-257; B. Braude i B. Lewis, po aty, f. 184-185.